



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon:

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11 të Ligjit për Zonat Ekonomike , Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe nenit 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës _____2022 të miratojë këtë :

PROPOZIM

VENDIM

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PUBLIK PËR VENDOSJE TË BIZNESEVE NË ZONËN EKONOMIKE "PARKU INDUSTRIAL" NË ZK QYLAGË –FAZA E PARË

I. Me këtë Vendim fillon procedura për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e parë.

II.OBLIGOHET, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim që menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi të shpallë Konkursin publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike "Parku Industrial" në ZK Qylagë- faza e parë.

III. Forma e konkursit publik, të përgaditet konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

IV. Qëllimi dhe destinimi i zonës së themeluar ekonomike është që kjo zonë ekonomike të shërbejë për inkurajimin e investitorëve që të konkurojnë në bazë të konkursit për investime prodhuese në mënyrë që të rriten mundësitë e punësimit dhe të punësohen punëtorë me përgatitje të profileve të ndryshme profesionale.

V. Parcelat kadastrale të cilat do të ipen në shfrytëzim në fazën e parë përfshijnë sipërfaqen prej 6.8 ha nga sipërfaqja e përgjithshme prej 56.27.56 ha në ngastrën kadastrale nr. P-71409090-00476-0 në ZK Qylagë.

VI. Prona e paluajtshme që do tu ipet në shfrytëzim subjekteve ekonomike do të jetë në afat prej 99 viteve.

VII. Bizneset të cilat do të përzgjidhen konform procedurave të përcaktuara me dispozita ligjore në tri (3) vitet e para nga dita e nënshkrimit të kontratës me komunën nuk do të paguajnë kompensim ndërsa pas tri viteve do të paguajnë kompensimin ____ € për m2 në bazë vjetore.

VIII. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi obligohet të bëjë ndarjen –parcializimin e sipërfaqes e cila planifikohet të ipet në shfrytëzim.

IX. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim - Vendimi është e përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Ligjit për Zonat Ekonomike, Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike dhe Statutit të Komunës.

Me Vendim të Kuvendit të Komunës 15Nr.313-34450 të datës 30.06.2016 është themeluar Zona Ekonomike në Qylagë . Me datë 18.05.2016, Ministria ka nxjerrë Vendimin nr. 2456 me të cilin i ka dhënë Pëlqimin Komunës së Lipjanit për themelimin e Zonës Ekonomike respektivisht parkut industrial në Qylagë të Lipjanit pastaj Komuna ka vazhduar procedurat tjera konform dispozitave ligjore.

Me këtë Propozim – Vendim po fillohet me procedurat për shpalljen e konkursit publik për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike “Parku Industrial” në ZK Qylagë- faza e parë konform dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr.03/2014 për procedurën, formën dhe përmbajtjen e konkursit, kushtet dhe kriteret për vendosjen e subjekteve afariste brenda hapësirave të zonave ekonomike.

Qëllimi dhe destinimi i zonës së themeluar ekonomike është që kjo zonë ekonomike të shërbejë për inkurajimin e investitorëve që të konkurojnë në bazë të konkursit për investime prodhuese në mënyrë që të rriten mundësitë e punësimit dhe të punësohen punëtorë me përgatitje të profileve të ndryshme profesionale.

Nga arsyet e cekura dhe në pajtim me dispozitat ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 011-25399
Lipjan, Më 18.05.2022

